



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:060887

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874070

KPPP.nr.387/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me seli në Prishtinë, rruga “Tringë Smajli” Nr. 19, kundër debitorit “Toi4” SH.P.K., me NUI: 810048860, me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Prizrenit” Nr. 62, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.337/2023 të datës 07.12.2023, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Toi4” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.337/2023 të datës 07.12.2023, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi Lubeniqi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.337/2023 të datës 07.12.2023, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi Lubeniqi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.337/2023 të datës 07.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 608362 të datës 30.06.2022; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh, t’ia paguaj kreditorit shumën në vlerë prej 1,858.50 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 30.06.2022 e deri në pagesën definitive, si dhe

të gjitha shpenzimet e përbarimit, në të kundërtën të caktohet përbarimi i dhunshëm me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përbaruesit privat e nga aty në llogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në pagesën e borxhit të kërkuar.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, duke deklaruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore, për faktin se faturat e lartcekur nuk përmban kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si dhe të njëjtat nuk janë të nënshkruara. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet në tërësi urdhri përbarimor dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj të gjitha shpenzimet të cilat janë krijuar si rezultat i fillimit të kësaj procedure përbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se fatura e lartcekur i përmban të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm për përbarim, ndërsa deklaratimet e debitorit janë të pathemelta dhe nuk janë vërtetuar me asnjë provë të vetme për përmbushjen e detyrimeve për shërbimin e marrë nga kreditori. Ka theksuar se debitori nuk i ka kontestuar shërbimet pasiqë i njëjti i ka kontraktuar policat e sigurimit dhe faturat i ka pranuar dhe nënshkruar, por që nuk preminë e sigurimit nuk e ka paguar. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të miratoj urdhrin përbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 608362 e datës 30.06.2022 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 608362 të datës 30.06.2022, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin nga ana e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit për kohën e përmbushjes së detyrimit monetar për faturën nr. 0608362 të datës 30.06.2022 dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.387/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.